




**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority  
Nr. i Prot./Br. Prot./Prot. No. 326/24-M/D  
Nr. i Fq./Br. St./No. Pg. 1/4  
Data/Datum/Date: 24.05.2024  
**PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA**

**Vendimi Nr.49/24**

**Datë: 24.05.2024**

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 24.05.2024, mori këtë;

## V E N D I M

**I. LEJOHET** Përqendrimi i ndërmarrjeve, Corvinus Nemzetközi Befektetési Zártkörűen Működő Részvénytársaság pjesë e Corvinus Group dhe Magyar Vagon Befektetési Vagyonkezelő Zártkörűen Működő Részvénytársaság pjesë e MOL Group, lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët të ndërmarrjes Talgo S.A (target)

**II.** Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguajë taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55.1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

## Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 05.04.2024, ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 221/24-11/H për Njoftim të Përqendrimit të ndërmarrjeve Corvinus Nemzetközi Befektetési Zártkörűen Működő Részvénytársaság pjesë e Corvinus Group dhe Magyar Vagon Befektetési Vagyonkezelő Zártkörűen Működő Részvénytársaság pjesë e MOL Group, lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët të ndërmarrjes Talgo S.A (targeti).

## Procedurat e ndjekura

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 26.04.2024
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 26.04.2024

## Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtar e kalon shumën 20,000,000 Euro
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro
3. Njoftimi për Përqendrim është i bazuar në letrën ofertuese, të datës 6 Mars 2024 të lidhur ndërmjet GMVE dhe Target-it, pastaj do të bëhet marrja e kontrollit të përbashkët nga Aplikuesit.

Ofruesi është Ganz-MaVag Europe Zrt (GMVE), e cila është një kompani Hungareze me adresë 1122 Budapest, Városmajor utca 13.6.em, Hungari dhe kodi LEI 875500V42WGFO5KXW371.

Corvinus Nemzetközi Befektetési Zártkörűen Működő Részvénytársaság, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me numër të biznesit 01-10-043547, më adresë Fény utca 16. II. emelet, 1024 Budapest, Hungari.

Corvinus është kompani holding, në pronësi të shtetit Hungarez dhe është pjesë e një grupi subjektesh që qeverisen nga Ministria Hungareze (Corvinus Group).

Ministria Hungareze i klasifikon kompanitë brenda Group Corvinus, në tri nëngrupe të më poshtme:

1. Një nëngrup kompanish aktive në tregun e shërbimeve financiare, të cilit i përket edhe vetë Corvinus;
2. Një nëngrup kompanish aktive në tregun e shërbimeve postare të kryesuara Magyar posta Zrt.
3. Një nëngrup kompanish aktive në menaxhimin e aseteve, e drejtuar nga një kompani kombëtare Hungareze MNV. MNV përbëhet nga 30 kompani hungareze aktive, në sektorë të ndryshëm duke përfshirë prodhimin e letrës, kartonit, shërbime inxhinierike, shërbime konsulence teknike shërbime administrative për rregullimin e kujdesit shëndetësor, arsimit dhe shërbime kulturore dhe shërbime të tjera sociale. Corvinus Group nuk ka filiale të regjistruar në Kosovë dhe nuk ka qarkullim financiar.

Magyar Vagon Befektetési Vagyonkezelő Zártkörűen Működő Részvénytársaság, (Magyar Vagon), është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me numër të biznesit 0110140260 me adresë Városmajor utca 10, 6 emelet, 1122 Budapest, Hungari, është pjesë e grupit të kompanive MOL Group, furnizues ndërkombëtarë i naftës dhe gazit me bazë në Hungari. Aktiviteti kryesor është kërkimi, prodhimi dhe rafinimi i naftës së papërpunuar, shpërndarja e produkteve të naftës së rafinuar si në nivelin e shitjes me shumicë ashtu edhe me pakicë, shitja e produkteve petrokimike, prodhimi dhe kërkimi i gazit natyror, si dhe transmetimin e gazit natyror në Hungari. Kërkesa për Përqendrim në Kosovë është bërë për arsye se MOL Group ka të regjistruar një filial, INA Kosova Sh.p.k.

INA Kosova Sh.p.k, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me numër të biznesit 70216036 me adresë, Lagjja Ulpiana, Bulevardi Dëshmorët e Kombit, objekti A1, Nr. 47.2 Hy.2 Nr.7.

Shoqëria është në pronësi të plotë të INA industria naftë d.d nga Kroacia. INA Kosova Sh.p.k, me aktivitet të regjistruar të shitjes me shumicë të lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta dhe të gazta dhe produkteve të ngjashme, shitja me pakicë e karburanteve për automjete në dyqane të

specializuara. Nuk shet mallra apo ofron shërbime palëve të treta, ofron vetëm shërbime me qira të depove brenda grupit dhe kështu, INA Sh.p.k Kosova gjeneron vetëm qarkullim brenda grupit, përmes nëngrupit INA i kryesuar nga kompania Kroate INA d.d, e cila gjeneron më shumë se 90% të qarkullimit të MOL Group në Kosovë.

Talgo S,A, është shoqëri aksionare me numër të biznesit A8445307, me adresë të regjistruar Las Matas, Paseo del Tren Talgo, 2,28290 Madrid, Spanje. Talgo është kompani mbajtëse e Target Group e cila është aktive në projektim, prodhim dhe mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse, mjete hekurudhore, trenat e shpejt, trenat rajonal, autobus etj. Target Group prodhon gjithashtu makineri ndihmëse, që mbulojnë të gjitha fushat e mirëmbajtjes, për të garantuar sigurinë e flotës dhe kushtet cilësore për operim dhe ofron shërbime gjithëpërfshirëse të mirëmbajtjes dhe rinovim të mjeteve lëvizëse. Target Group është i pranishëm në tetë vende: Spanjë, Gjermani, Danimarkë, Arabi Saudite, Danimarkë, Egjipt, Shtetet e Bashkuara, Kazakistan dhe Uzbekistan.

Grupi i synuar nuk është aktiv, nuk gjeneron asnjë qarkullim dhe nuk ka asnjë filiale të regjistruar në Kosovë. Ndarja e aksioneve të GMVE, do të bëhet ndërmjet Aplikantëve, ndërmarrja Corvines do të mbaj 45% të aksioneve të GMVE, dhe Magyar Vagon do të mbaj (Indirekt) 55 % të aksioneve te GMVE.

### **Tregu Përkatës**

**Tregu i produktit:** Tregu për prodhimin dhe furnizimin të mjeteve lëvizëse, si dhe furnizimi për pjesë të këmbimit për mjete, po ashtu edhe mirëmbajtje dhe rinovimet e mjeteve lëvizëse.

**Tregu gjeografik:** konsiderohet si treg ndërkombëtarë.

### **Analiza e konkurrencës**

Transaksioni i propozuar nuk mund të prodhojë asnjë efekt negativ në tregun e Kosovës dhe si rrjedhojë nuk do të ndikojë në interesat e konsumatorëve dhe nuk do të përfshijë ndonjë efekt të mundshëm koordinues ndërmjet Corvinus Group dhe MOL Group, përmes kontrollit të tyre të përbashkët mbi Target Group, duke marrë parasysh se nuk do të ketë mbivendosje ndërmjet aktiviteteve të palëve në tregjet përkatëse në Republikën e Kosovës, gjithashtu nuk rezulton mbivendosje horizontale apo vertikale ndërmjet palëve në tregun e Kosovës, për arsye se Targeti nuk ofron shërbime në Kosovë, që domethënë palët nuk veprojnë në treg të njëjtë të produktit.

### **Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar**

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë, për arsye se MOL Group ka të regjistruar një filiale në Kosovë, INA Kosova Sh.p.k. Shoqëria është në pronësi të plotë të INA industria naftë d.d nga Kroacia. INA Kosova Sh.p.k, me aktivitet të regjistruar të shitjes me shumicë të lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta dhe të gazta dhe produkteve të ngjashme, shitja me pakicë e karburanteve për automjete në dyqane të specializuara. Duke pasur parasysh që tregu i karburanteve në Kosovë është mjaft konkurrues, pasi që kemi një numër të madh të kompanive që kanë këtë veprimtari, prandaj ky treg është mjaft konkurrues dhe si i tillë nuk ngritë ndonjë shqetësim për konkurrencën në Republikën e Kosovës. Transaksioni do të ndodhë në Hungari, prandaj MOL Group në Kosovë, do të mbetet i pandryshuar me aktivitetet e saj dhe nuk do të ketë ndikim në asnjë mënyrë në sektorin e naftës.

Komisioni, ka vlerësuar se përqendrimi, nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit, nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës, për arsye se ky transaksion, nuk do të ndikojë në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse, tek operatorët ekonomik apo konsumatorët, përkatësisht objekti i kontratës nuk korrespondon, me tregun përkatës, të Republikës së Kosovës.

### Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij, Propozim Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

## AUTORITETI I KONKURRENCËS KOMISIONI



Neimë Binaku-Isufi  
Kryetare

Kaltrina Sela  
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj  
Anëtare

Florent Mehmeti  
Anëtar

Salihe Gashi-Loku  
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva